



## V E N D I M

*Nr. 116 Date 01.10. 2008*

**MBI VAZHDIMIN E KRYERJES SE AKTIVITETIT TE IMPORTIT DHE EKSPORTIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE NGA TE LICENSUARIT NE KETO AKTIVITETE PER PERIUDHEN E MBETUR TE VLEFSHEMRISE SE LICENSES SI AKTIVITET I TREGTIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa a, 9, dhe 13 pika 8, të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 1 pika 1, dhe 8 pika 1 të Licenses për aktivitetin e importit të energjisë elektrike të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionereve Nr.55, datë 12.10.2005, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 01.10.2008, mbasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për trajtimin e të licensuarve deri me tani nga ERE për aktivitetin e importit dhe eksportit të energjisë elektrike si të licensuar për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike

**Dhe konstatoi se:**

- Me miratimin e ligjit nr. 9913, date 5.05.2008 ”Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072 date 22.05.2003 ”Për sektorin e energjisë elektrike”, është shfuqizuar licensimi i aktiviteteve për importin dhe eksportin e energjisë elektrike dhe vendoset si aktivitet i licensuar tregtimi i energjisë elektrike
- Në pikën 2 të modelit të tregut të energjisë elektrike të miratuar me VKM nr.338 date 19.03.2008, përcaktohen si pjesëtarë të tregut, tregtuesit të cilët në kutpim të modelit të tregut kryejnë praktikisht aktivitetin e importit dhe eksportit të energjisë elektrike por tani me nën emërtim Tregtar të energjisë elektrike.
- Gjithashtu Modeli i tregut të energjisë elektrike, në pikën 7 përcakton edhe autoritetin e ERE për kryerjen e rishikimeve të nevojshme në aktet nënligjore si pjesë e rëndësishme të funksionimit të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.
- Licenca për importin e energjisë elektrike e miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionereve nr. 55 date 12.10.2005 parashikon se ERE mund të amendojë kushtet e licenses në rast se ato nuk përputhen me legjislacionin në fuqi .



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**  
Bordi i Komisionereve



Per gjithë sa me sipër Bordi i Komisionereve të ERE-s,

**Vendosi**

1. Duke filluar nga hyrja në fuqi e këtij vendimi të gjithë personat e licensuar nga ERE për aktivitetin e importit dhe eksportit të energjisë elektrike do të vazhdojnë të kryejnë aktivitetin në sektorin e energjisë elektrike për periudhën e mbetur të vlefshmerisë së licenses, si të licensuar në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike duke qenë subjekt i kushteve të licenses për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë personat e licensuar nga ERE në aktivitetin e importit dhe eksportit për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari I ERE-s**

**Bujar Nepravishta**